



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



**Referenca : 626/21/020/236**

Në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik A01 neni 41 pika 41.5 dhe në bazë të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të rregullores së Prokurimit Publik neni 6 paragrafi 6.3, neni 7 paragrafi 7.2 si dhe neni 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 bie këtë :

## V E N D I M

### I

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për Rishqyrtim të Operatorit Ekonomik – Kompania e Sigurimeve “SCARDIAN” J.S.C. nga Prishtina e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës së prokurimit me datën 28.07.2021 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-21-4596-2-3-6 dhe nr. të brendshëm: 626-21-020-2-3-6 me titull: “SIGURIMI TPL DHE TPL+ I AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS - RITENDER”

### II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik SCARDIAN J.S.C. Adresa: Perandori Justinian nr.3 Prishtinë me datën 28.07.2021 përmes platformës elektronike të prokurimit, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim mbi njoftimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues me të cilin është përcaktuar përfituesi i tenderit për “ Sigurimi TPL dhe TPL+ të Automjeteve zyrtare të Komunës së Mamushës-Ritender.

Si autoritet kontraktues, pas pranimit të kërkesës brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 të Rregullores për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, kemi shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga O.E “Scardian” J.S.C. i cili në deklaratën e tij detale mbi faktet dhe argumentet në nenin 7. ndër të tjera na njofton rreth kompanisë së kompania, është e licencuar nga BQK dhe është e regjistruar në ARBK si dhe na njofton mbi aktivitetet të cilat i ka të licencuara si kompani. Ne si Autoritetit Kontraktues gjatë vlerësimit, kemi konstatuar se kompania në fjalë i ka plotësuar tri kërkesat e parapara në dosjen e

tenderit në nenin III.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale të kërkuara në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, por nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 4 në të cilën është paraparë kërkesa si vijon: 4. Operatorët ekonomik duhet të jenë të Licencuar si Kompani të Sigurimit nga BQK, me të cilën autorizohen të kryejnë shërbime sigurimesh në territorin e Kosovës.

Dhe si dëshmi janë kërkuar dokumentet si në vijim:

4. Licencë për Kompani të Sigurimit **(kopje e noterizuar)**.

Pas vlerësimit të tenderit të O.E. ankues, është konstatuar se O.E. ka dorëzuar një kopje të pa noterizuar të licencës. Sa i përket kësaj pike, O.E. ankues në kërkesën për rishqyrtim ka cekur se nuk është e nevojshme të jetë e noterizuar licenca pasi që BQK është mbikëqyrës i joni dhe licenca jepet vetëm një herë. Mirëpo në nenin 59 të LPP-s, decidivisht është paraparë që për të qenë një tender i përgjegjshëm, ai duhet të jetë administrativisht në rregull dhe ti plotësojë të gjitha kërkesat dhe dokumentet të kërkuara në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë. Andaj, është konstatuar që O.E. nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 4 pasi që nuk e ka dorëzuar dëshminë e kërkuar në pikën e cekur më lartë.

O.E. në pretendimin e tij ka kërkuar sqarim se në bazë të cilit vendim është bërë shpallja e fituesit të tenderi me të cilën është shpallur fitues O.E. “EUROSIG” SH.A. kur dihet se e njëjta kompani ka bërë shkelje dhe thyerje të tarifës së sigurimit TPL.

Në nenin 3 të LPP-s në fuqi janë paraparë përjashtimet e LPP-s dhe duke u bazuar në dispozitat në fjalë, sigurimi TPL dhe TPL+ nuk është i përjashtuar, andaj si Autoritet Kontraktues kemi shpallur tenderin në fjalë, duke e përcaktuar kriterin për dhënie të kontratës në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë i cili ka qenë **“Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”**

Me qenë se O.E. . “EUROSIG” SH.A. ka dorëzuar tender të përgjegjshëm, sepse i ka plotësuar të gjitha kërkesat në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë si dhe ka dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët, ne duke u bazuar në nenin 59 të LPP-s, kemi vendosur që të njëjtin ta shpërblejmë me kontratë për shërbimet e përcaktuara në procedurën e prokurimit në fjalë.

Si autoritet kontraktues, kemi kompetenca dhe jemi të obliguar që të zbatojmë legjislacionin e Prokurimit në fuqi, andaj edhe në këtë rast kemi ndjekur të gjitha hapat e kërkuara nga LPP-ja si dhe gjate procedurës se vlerësimit të tenderit në fjalë me qenë se si kriter për dhënie të kontratës kemi përcaktuar kriterin “Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët” duke u bazuar në këtë kriter, kemi vendosur që O.E. . “EUROSIG” SH.A. të shpërblehet me kontratë për këtë procedurë të prokurimit.

Sa i përket pretendimit se Kompanitë të cilat kanë ofruar çmimin më të lirë se 8,368.58 € për një vit, në bazë të specifikave teknike për kontratën në fjalë, kanë bërë shkelje të tarifave, konsiderojmë se ne nuk kemi kompetencë që ta bëjmë analizimin dhe vlerësimin e çështjeve të tarifave si dhe të kujdesemi për shkeljet rreth tarifave të cilat kompanitë i bëjnë dhe të cilat O.E “Scardian” J.S.C. i ka theksuar në kërkesën për rishqyrtim. Për një çështje të tillë ju si kompani mund të paraqitni rastin pranë BQK-s si autoritet përgjegjës. Nga tri kompani të cilat kanë paraqitur tenderin e tyre, asnjëra nga ofertat nuk e kanë çmimin e njëjtë, andaj sa i përket kësaj çështje dispozitat e LPP-s e kanë rregulluar shumë qartë se do të shpërblehet me kontratë O.E. i cili i ka plotësuar të gjitha kërkesat në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë dhe ka ofruar tenderin me çmimin më të ulët.

Operatori Ekonomik ankues nuk e ka plotësuar edhe kërkesën formale administrative të paraparë në nenin II.6 Afatet kohore për nisje dhe/apo përfundim të kontratës në të cilën është kërkuar si vijon :

Kjo kontratë publike ka kohëzgjatje prej 24 muajsh dhe do të filloj të ekzekutohet menjëherë pas nënshkrimit të sajë.

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që me tenderin e tyre të dorëzojnë Afatin e kryerjes së shërbimit.

- Afati i kryerjes së shërbimit, nuk duhet të jetë më i gjatë se 5 (Pesë) ditë.

Në këtë kërkesë është paraparë shumë qartë se rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do të refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.

Arsyetimi se kërkesa nuk ka qenë e vendosur sipas standardit të kërkesave tek kërkesat e përshtatshmërisë në dosje të tenderit, mirëpo është vendosur tek qëllimi i kontratës dhe nuk është vendosur sipas standardit të kërkesave në dosje, është i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm. Kërkesat formale administrative nuk vendosen tek kërkesat e përshtatshmërisë.

Në ftesën për tender në dosje të tenderit, është sqaruar saktë se nga ju pritet që të ekzaminoni me kujdes të gjitha pjesët dhe seksionet e kësaj dosje të tenderit dhe anekset e saj dhe të pajtoheni me të gjitha kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përfshira në dosje të tenderit. Gjithashtu në formularin e dorëzimit të tenderit në pjesën I Formulari i Tenderit të cilin e ka dorëzuar O.E. ankues, në pikën 1 ka pranuar se: 1. I ka kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit dhe se ne pranojmë dispozitat e sajë në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

Konsiderojmë se faktet e paraqitura më lartë janë të pa kontestueshme të cilat janë vërtetuar edhe në procesverbalin e vlerësimit të tenderit.

### **Andaj**

Konsiderojmë se Operatori Ekonomik ankues, kërkesën për rishqyrtim e ka bërë duke mos pasur kurrfarë baze juridike në parashtrimin e kërkesës, kështu që u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me 29.07.2021

Gazmend Gashi  
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit  
Komuna Mamushë

Këshilla juridike:Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej dhjet (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.